

DUKE E FOLUR GJUHËN E SPORTIT NË KOSOVË

RADIO SKRIPTA

FOLËSI

Kampionati Botëror i Futbollit është kohë e ngazëllimit. Gjithçka ka të bëjë me gëzim, garë dhe krenari kombëtare. Por ka të bëjë edhe me paqe dhe me fuqinë e sportit të bashkuar njerëzit nga i tërë rruzulli tokësor.

Robert Sorenson është zëvendës shef i misionit të OKB-së në Kosovo, UNMIK-ut.

ROBERT SORENSON, UNMIK

Sporti është mjet i fuqishëm për të afruar njerëzit përmes promovimit të respektit të ndërsjellë dhe idealeve të vëllazërisë, tolerancës dhe drejtësisë. Po ashtu historikisht ka luajtur rol të rëndësishëm në të gjitha shoqëritë. Sporti e ka fuqinë unike që të tërheqë, mobilizojë dhe frymëzojë. Për nga vet natyra e tij, sporti ka të bëjë me pjesëmarrje. Ka të bëjë me përfshirje dhe qytetari. Afirmon vlerat njerëzore si respektin ndaj kundërshtarit, pajtimin me rregulla, dhe drejtësinë të gjitha këto parime të mishëruara edhe në Kartën e OKB-së.

FOLËSI

Lidhja mes sportit dhe paqes është theksuar nga zyrtarë të OKB-së anëmbanë botës, përfshirë edhe Sekretarin e Përgjithshëm Ban Ki-moon.

BAN KI-MOON

Sporti mund të përdoret për bashkimin e ndarjeve kulturore, fetare, etnike dhe sociale.

FOLËSI

Robert Sorenson nga UNMIK-u së fundi inauguroi një fushë sportive në Kosovën perëndimore për fëmijët e të gjitha përkatësive etnike.

ROBERT SORENSON, UNMIK

Ishte njëmend ngazëllyese të shihje fëmijët në fushë, duke luajtur së bashku, pa asnjë dallim ndaj përkatësive etnike ato nuk luanin rolin fare. Ata ishin të interesuar vetëm të luanin dhe të kënaqeshin dhe ta njihnin njëri tjetrin përmes lojës.

FOLËSI

Përpos financimit të fushës sportive, UNMIK-u e ka mbështetur projektin e shoqërisë civile të quajtur "Sport4Peace" (Sport për Paqe) i cili u kurorëzua me një turnir futbollit për dyqind fëmijë nga gjashtë grupe etnike. UNMIK-u mbështet projekte të tilla sportive për promovimin e pajtimit dhe ndërtimin e besimit në mes të komuniteteve të ndryshme në Kosovë. Por, fundja, këto lidhje mund të forcohen vetëm përmes vetë njerëzve. Radio Ophelia ishte e pranishme në të dy ngjarjet dhe bisedoi me pjesëmarrësit e rinj rreth sportit dhe si mundet sporti të bashkojë ata.

INTERVISTA ME TË RINJ

Blerta

Të gjithë njerëzit e botës mund të luajnë futboll pa dallim race, gjinie apo dicka tjetër. Të gjithë janë të barabartë në futboll.

Olti

Kur luajmë, ja japim dorën njëri tjetrit në fund. Dhe kështu ne bëhemi shokë.

Stefan

Kur luajmë futboll, fillojmë të shoqërohemi dhe kështu bëhemi shokë. Sporti është mënyrë e mirë për të bashkuar njerëz nga komunitetet e ndryshme.

Aleksa

Kam dëshirë të luaj sport sepse njoftohemi me fëmijë të komuniteteve tjera. Shoqërohemi së bashku dhe kjo më frymëzon.

FOLËSI

Robert Sorenson nga UNMIK-u ka parë se fëmijët nga e tërë Kosova kanë së paku një gjë të përbashkët. Ata e flasin gjuhën e sportit .

ROBERT SORENSON, UNMIK

E dini, ekziston një mit në Kosovë që fëmijët nuk komunikojnë me njëri tjetrin nëse janë prej grupeve të ndryshme etnike. Thuhet se një fëmijë serb nuk mund të bisedojë me një fëmijë shqiptar sepse nuk e njohin gjuhën dhe ndihen si të ndarë. Por kur këta fëmijë janë në fushë sporti, sidomos fëmijët më të vegjël, është një gjë e mrekullueshme, dhe ata komunikojnë me njëri tjetrin dhe ndonjë herë, çuditërisht, ata edhe dijnë fjalë nga gjuha e njëri tjetrit. Por, ekziston edhe gjuha e sportit, dhe si të luhet sporti është ajo që me të vërtetë shkon përtej, dhe asisoj zhvillon kontakte dhe këto kontakte mund të jenë aq të rëndësishme për zhvillimin e respektit të ndërsjellë, mirëkuptimin, dhe, sinqerisht, për të kuptuar se njerëzit janë të ndryshëm por jemi të njejtë poashtu.